

V E N D I M
Nr.528 datë 17.10.1994

**PËR MËNYRËN E PAGESËS SË BANESAVE QË FINANCOHEN NGA ENTI KOMBËTAR I
BANESAVE**

Me propozimin e Ministrisë së Ndërtimit, të Strehimit dhe Rregullimit të Territorit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Pas fillimit të punimeve në çdo banesë të financuar nga Enti Kombëtar i Banesave, organet e pushtetit lokal hartojnë listat e qytetarëve të planifikuar për strehim sipas kritereve që përcaktohen me vendimin e Këshillit të Ministrave “Për mënyrën e ndarjes së apartamenteve të ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave”.

2. Enti Kombëtar i Banesave, pas verifikimit të këtyre listave, sipas destinacionit të investimit të përcaktuar nga vetë Enti, me fillimin e punimeve, brenda një muaji, lidh kontrata të përkohshme të shitjes së apartamenteve.

3. Në momentin e lidhjes së kontratave blerësit e caktuar si më sipër do të parapagujnë sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.291, datë 21.6.1994 “Për kriteret e vlerësimit të apartamenteve që ndërtohen me fonde shtetërore”, ndryshuar me vendimin nr.421, datë 22.8.1994, dhe udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr.4, datë 22.8.1994 “Për vlerësimin e apartamenteve që ndërtohen me fonde shtetërore”.

Me përfundimin e objektit lidhet kontrata përfundimtare.

4. Në rast se blerësi refuzon të bëjë këtë parapagim, i humb e drejta e autorizimit dhe e lidhjes së kontratës.

Pas njoftimit nga Enti Kombëtar i Banesave, organet e pushtetit lokal, brenda një muaji, lëshojnë autorizimet për qytetarë të tjerë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi